



## Koronavirus : informacion lidhur me vaksinën në kantonin Valais

*Vaksina është falas dhe me dëshirë*

### Kur mund të vaksinohem ?

- Nisur nga mosha 12 vjeç.
- Nëse nuk kam temperaturë ose simptoma të tjera të Kovid-19
- Nëse nuk kam alergji nga përbërësit e vaksinës (PEG). Në rast dyshimi, kontaktoni mjekun tuaj.
- Nëse nuk jam në izolim ose në karantinë.
- Që nga tremujori i dytë për gratë shtatzëna (pas pëlqimit me shkrim dhe analizës së përfitimit/rrezikut gjatë një takimi me mjekun e saj)

### Si të vaksinoheni ?

Vaksinimi është gjithashtu i mundur te disa mjekë ose në farmaci. Informohuni nëpërmjet e-mail-it/telefonit te mjeku ose farmacia në fjalë për regjistrim.

Vaksinimi është gjithashtu i mundur në qendrat e vaksinimit në Brig, Sion dhe Collombey **me regjistrim** në adresën <https://vs.covid-vaccin.ch>. Para fillimit të procesit të regjistrimit ju duhet të keni me vete kartën tuaj të sigurimit shëndetësor dhe një telefon mobil. Nëse nuk jeni të mësuar me mjetet informatike, kërkoni ndihmë te një person i afërt ose telefononi në linjën telefonike : +41 58 433 0 144.

Nëse ka vënde të lira, është gjithashtu e mundur të vaksinohen **pa takim** personat 16 vjeç e lart në qendrat Brig, Sion dhe Collombey. Ditët dhe oraret në : <https://vs.ch/coronavirus>.

### Si të vaksinohen fëmijët nga 12 deri në 15 vjeç ?

Prindërit që dëshirojnë të regjistrojnë fëmijën e tyre për vaksinim janë të ftuar të kontaktojnë drejtëpërdrejt pediatrin ose mjekun e tyre. Në rast se mjeku nuk bën vakcina kundër Kovid-19, vaksinimi i kësaj grupmoshe është gjithashtu i mundur, vetëm me takim në vendet e mëposhtme :

- Kabineti mjekësor i Dr Simon Fluri (Viège)
- Qendra e vaksinimit në Sion
- Qendra pediatrike multidisciplinare në Chablais valaisan (Monthey)

Regjistrim në <https://vs.covid-vaccin.ch>

- Kabineti mjekësor i Dr Jean-Michel Poncet (Monthey) ; regjistrimi me e-mail në [jmponcetped@hotmail.com](mailto:jmponcetped@hotmail.com) ose me telefon në 024 472 12 62

Informacione të përgjithshme COVID-19 në Valais : <https://vs.ch/coronavirus>  
Informacione të përgjithshme COVID-19 në Zvicër : <https://ofsp-coronavirus.ch>  
Linja telefonike në kantonin Valais në **+41 58 433 0 144** u përgjigjet të gjitha pyetjeve ose vështirësive në lidhje me regjistrimet në qendrat e vaksinimit..